



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT

**O M B U D S M A N**  
Republic of Macedonia

Mehanizmi Parandalues Nacional, më datë 02.04.2015, realizoi vizitë të jashtëzakonshme në Qendrën për Pranimin e të Huajve, me qëllim që të konstatojë se a janë ndërmarrë masat nga rekomandimet e dhëna paraprakisht, si dhe ta konstatojë gjendjen aktuale. Gjatë vizitës u konstatua se në këtë Qendër janë të vendosur 160 burra, si dhe 22 gra me 4 fëmijë.

Duke e pasur parasysh se Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, me Rezolutën 2020 (2014) të datë 03.10.2014, rekomandoi që të pengohet ndalimi dhe privimi nga liria i fëmijëve migrantë ilegalë dhe të gjenden modele alternative të qëndrimit të cilët do të jenë në drejtim të interesit më të mirë të fëmijëve, Mehanizmi Parandalues Nacional u informua se pjesa më e madhe e grave dhe fëmijëve tashmë janë vendosur në objektin në afërsi të Qendrës për Azilkërkues në Vizbeg, si dhe se planifikohet që edhe gratë edhe fëmijët, të cilët gjenden në Qendrën për të Huaj, së shpejti të dërgohen atje.

Gjatë kohës së zhvillimit të kësaj vizite, u konstatua përmirësim në aspekt të realizimit të mbrojtjes shëndetësore, përkatësisht angazhimit të përditshëm të mjekut, i cili është me prejardhje nga Siria dhe kryen kontrole në Qendër, në periudhën nga ora 10:00 deri në ora 15:00. Së këtejmi, u vu re se personat e pranuar të ri kontrollohen me rregull dhe në kohë nga mjeku, por megjithatë një pjesë e ankesave të migrantëve kanë të bëjnë me cilësinë e mbrojtjes shëndetësore të cilën e pranojnë në Qendër, ndërsa një pjesë e tyre u ankuan se ata detyrohen që medikamentet t'i sigurojnë vet. Gjatë bisedës me mjekun, MPN-ja u informua se ka në dispozicion medikamente të mjaftueshme, ndërsa në rast nevojë personat i dërgon në klinikë.

Edhe më tej, një pjesë e migrantëve të vendosur u ankuan se nuk mund ta realizojnë të drejtën e azilit, ndërsa nga ana e drejtorisë u tha se e njëjta kushtëzohet me lejen të cilën duhet ta aprovojë prokurori publik. Gjatë këqyrjes së Librit për ngjarje të ditës u vërejt se personat gojarisht e paraqesin kërkesën për azil, po ashtu MPN-ja gjatë bisedës me migrantët e vendosur u informua se për një periudhë më të gjatë kohore presin transferimin në Qendrën për Azilkërkues në Vizbeg. Gjithashtu, qëndrimi i gjatë, por edhe kushtet e këqija të vendosjes ishin shkak që numri më i madh i personave të vendosur e filluan grevën e urisë.

Sikurse edhe në vizitat paraprake, MPN-ja konstatoi se nuk realizohet e drejta e shëtitjeve, përkatësisht nuk zbatohet në mënyrë të barabartë dispozita për sigurimin e shëtitjes në ambient të hapur dy herë në ditë nga një orë për personat e huaj ose në përgjithësi dy orë në ditë, për shkak se vet objekti nuk është i siguruar me gardh dhe nuk ka hapësirë të mjaftueshme për realizimin e kësaj të drejte për të gjithë personat e vendosur në Qendër. Kushtet në pjesën e burrave nuk kanë ndryshuar, përkatësisht edhe më tej një pjesë e madhe e personave flenë në dysheme ose në thasë për gjumë.

Për vizitën në Qendrën për Pranimin e të Huajve, Avokati i Popullit – Mehanizëm Parandalues Nacional i dërgoi informatë të veçantë Ministrisë së Punëve të Brendshme.